



Prishtinë: 27.08.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1278_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2064_06_20**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **16.07.2020**.

në seancën e mbajtur më datë 27.08.2020, nxori këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin K.E. nga Komuna e Pejës, me shifër të konsumatorit **DPE 69474** si e pa bazuar.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_2064_06_20 i datës 12.06.2017.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 18.07.2017 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-s, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë, për konsumatorin K. E. nga Komuna e Pejës, lidhur me kontestimin e faturave të muajve 07, 08, 09 të vitit 2017, për këto shkaqe: faturat e larta i janë dërguar konsumatorit nëntë (9) muaj pas ndërrimit të njehsorit, dhe jo siç pretendon DMK se ka rritje të shpenzimeve me njehsorin e ri. Kundërshtimi tjetër ka të bëjë me faktin se me rastin e ndërrimit të njehsorit pika matëse ka qenë në rregull dhe se për 9 muaj nuk është evidentuar ndonjë parregullësi, dhe se faturimi për periudhën 9 mujore nuk kontestohet nga asnjëra palë. Më tej, ndër të tjera, KESCO pretendon që defekti në pajisje apo instalime të brendshme janë përgjegjësi e konsumatorit dhe nuk ka asnjë dëshmi që dokumenton që KEDS është përgjegjës për defektin në fjalë.

Bazuar në këtë KESCO kërkon nga Bordi që të pezulloi vendimin e DMK/ZRRE_V_2064_06_20, në lidhje me shifrën DPE – 69474.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.08.2020 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimet e përfaqësuesit të KESCO-së, se rritja e shpenzimeve të energjisë elektrike është bërë 9 muaj pas vendosjes së njehsorit së ri dhe se rritja e shpenzimeve nuk lidhet



domosdoshmerisht më vendosjen e njehsorit të ri siç është arsyetuar në vendimin e DMK-së, Bordi i ka vlerësuar si të paqëndrueshme, për faktin se bazuar në analizat e bërë rrjedhës së energjisë elektrike dhe shkresave të lëndës, ka rezultuar se faturimi i periudhës qershor, korrik dhe gusht të vitit 2017 nuk paraqet shpenzim real të konsumatorit. Bordi i ZRRE-së gjithashtu thekson se ky faturim ka ardhur pasi punëtorët e autorizuar të KEDS përmes procesverbalit nr.0620605 të datës 19.10.2016 kanë bërë ndërrimin e pikës matëse dhe se kanë bërë zhvendosjen e njehsorit elektrik nga shtëpia në shtyllë, si dhe kanë evidentuar të gjitha elementet përbërëse teknike të vendosura. Në procesverbalin e KEDS-it nr. 0056442 datë 08.08.2017 vetëm është theksuar se njehsori elektrik ka kontakt në tabelën e ormanit në shtëpi, por nuk ka dhënë detaje të mëtutjeshme se si ka ardhur deri te ky kontakt. Lidhur me këtë Bordi i ZRRE thekson se sipas nenit 54, par.1 i Ligjit për Energjinë Elektrike, Pajisjet matëse për matjen e energjisë elektrike janë pronë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, siç përcaktohet në Ligjin për Energjinë.

Sa i përket pretendimit të KESCO që defekti në pajisje apo instalime të brendshme janë përgjegjësi e konsumatorit dhe nuk ka asnjë dëshmi që dokumenton që KEDS është përgjegjës për defektin në fjalë, Bordi i ZRRE ka analizuar me kujdes dy procesverbale të KEDS-it, procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0620605 të datës 19.10.2016, si dhe raportin mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr. 0056442 të datës 08.08.2017 dhe ka konstatuar se me rastin e ndërrimit të njehsorit elektrik si dhe rregullimit të kycjes së konsumatorit, punëtorët e KEDS-it është dashur që t'i marrin të gjitha masat që të mos ketë gabime në kycje, përkatësisht të eliminohen mundësitë e çfarëdo kontakti i cili do të shkaktonte mos regjistrim të saktë të shpenzimit të energjisë elektrike.

Bordi duke e pasur parasysh analizën e rrjedhës së energjisë elektrike, si dhe që faturimi i periudhës qershor, korrik dhe gusht 2017 nuk paraqet shpenzim real të konsumatorit, e në veçanti bazuar edhe në dy procesverbalet e KEDS-it, procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0620605 e datës 19.10.2016, si dhe raportin mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr. 0056442 të datës 08.08.2017, konstaton se konsumatorit duhet t'i anulohen faturat e periudhës kontestuese (06/07/08/2017) dhe se për këtë periudhë duhet të faturohet me shpenzimet e regjistruara në periudhën 06/07/08 të vitit 2018.

Bordi i ZRRE gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.08.2020 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit K.E. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së.